

VENDIM
Nr. 804, datë 30.9.2020

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 143, DATË
13.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT PËR
LËSHIMIN E AUTORIZIMIT, PËR SUBJEKTET E RINDËRTIMIT DHE PËR
PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR TË FURNIZIMIT TË
MALLRAVE E SHËRBIMEVE, PËR QËLLIME TË PROCESIT TË
RINDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 53, shkronjat “I” e “II”, dhe 56, pika 28, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 143, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 3, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) nënkontraktorët, të cilët kanë lidhur kontrata me ndërtuesit/kontraktorët e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të këtij neni, për furnizimin e proceseve të ndërtimit, si dhe furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar.”.

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 4

Për qëllime të zbatimit të përjashtimeve të mësipërme, subjektet e përcaktuara në nenin 3, të këtij vendimi, duhet të jenë të autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Për t’u pajisur me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën me shkrim, së cilës i bashkëlidhet një fotokopje e certifikatës së NIPT/NUIS-it;
- b) Marrëveshjen kuadër, që kanë lidhur me njësinë zbatuese për secilën procedurë prokurimi publik të programit të rindërtimit, sipas parashikimeve në ligjin e fushës, në rastin e ndërtuesit/kontraktorëve;
- c) Marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorit, në rastet kur ndërtuesi, subjekt i rindërtimit, është përcaktuar nga donatori që ka marrë përsipër procesin e ndërtimit, në përputhje me programin e rindërtimit;
- ç) Preventivin e punimeve, mbi bazën e të cilit janë përzgjedhur fitues për kontratat publike për punime/shërbime ndërtimi, në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, shoqëruar kjo me listën e detajuar të materialeve që do të përdoren në procesin e ndërtimit, në rastin e ndërtuesit/nëkontraktorëve;
- d) Kopjen e lejes së ndërtimit, të miratuar nga organet kompetente, në rastin e ndërtuesve;
- dh) Kontratën e lidhur me ndërtuesin/kontraktorin, në rastin e furnizuesve të mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar, kontraktorë/nëkontraktorë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga subjektet e rindërtimit. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditor.

Bazuar në rezultatet e shqyrtimit, kur përmbushen kërkesat e përcaktuara dhe është plotësuar dokumentacioni i sipërpërmendur, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, lëshon autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja për subjektet e rindërtimit.

Një kopje e autorizimit, së bashku me dokumentacionin shoqërues i përcillet drejtorisë rajonale tatimore përkatëse, që ka në administrim tatimpaguesin, subjekt të rindërtimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen zyrtare dhe mban të përditësuar listën e subjekteve të rindërtimit, të cilat janë pajisur me autorizim përjashtimi nga TVSH-ja, ku pasqyrohen të dhënat identifikuese të tatimpaguesit, NIPT/NUIS-i, numri dhe data e lëshimit të autorizimit.

Furnizuesit e mallrave/shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja për procesin e ndërtimit, në momentin e lëshimit të faturës tatimore duhet të shënojnë në faturë dispozitën ligjore, sipas së cilës furnizimi është i përjashtuar, si dhe numrin e datën e autorizimit të përjashtimit.

Gjithashtu, furnizuesi i bashkëlidh kopjes së faturës tatimore, që mban vetë, edhe një kopje të autorizimit të përjashtimit.

Asnjë përjashtim nuk akordohet për furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që nuk furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, të cilat i importojnë vetë mallrat që do të përdoren prej tyre për procesin e ndërtimit, pas marrjes së autorizimit të përjashtimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, paraqiten pranë autoritetit doganor për të përfituar përjashtimin në import për këto mallra.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton procedurë/manual të posaçëm, me qëllim kontrollin e zbatimit të përjashtimeve, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar.”.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184, datë 16.10.2020